

LIGJ
Nr. 137/2014

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK PËR VITIN 2013

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 158 të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratimi i buxhetit faktik

Miratohet buxheti faktik për vitin 2013, së bashku me burimet e tij të financimit, si më poshtë:

Në milionë lekë

1. Buxheti i Shtetit	
Të ardhurat, gjithsej	268 706
Shpenzimet, gjithsej	322 067
2. Buxheti i sigurimeve shoqërore	
Të ardhurat	95 717
Shpenzimet	95 597
3. Buxheti i sigurimeve shëndetësore	
Të ardhurat	16 448
Shpenzimet	30 147
4. Deficiti buxhetor	- 66 940
5. Financimi i deficitit buxhetor	66 940
I brendshëm	56 129
A. Me instrumente financiare (kredimarrje e brendshme, neto)	46 298
1. Kredimarrje nga pushteti qendror	46 196
Bono thesari	- 4 586
Obligacione qeveritare 2/3/5/7/10-vjeçare	50 782
2. Kredimarrje nga pushteti vendor	102
B. Të ardhura nga privatizimi	16 703
B.1. Pagesa e prapambetur e TVSH-së së rimbursueshme Kurum	
	-
	3 473
C. Të tjera	- 3 399
Ndryshimi i gjendjes së arkës	- 9 618
Të tjera	6 219
Financimi i jashtëm (neto)	10 811.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.10.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8769, datë 4.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**